



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201600251/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2016

**Lënda :** Rekomandohet "Kryerja e ekspertimit psihiatriko-ligjor për personin nën hetim S. K., antar i Komunitetit Rom, akuzuar për veprën penale "Vjedhja" e mbetur në tentative", parashikuar nga neni 134 e 22 të Kodit Penal".

**Drejtuar :** Drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor  
Z.Petrit FUSHA

**TIRANË**

*I nderuar Z.FUSHA,*

Në Instiucionin e Avokatit të Popullit më datë 17.02.2016, ka paraqitur ankesë shtetasja D. K., banuese në Shkozë të Tiranës, antare e Komunitetit Rom, e cila ngre pretendimin se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në kërkesën drejtuar gjykatës për caktim mase sigurimi "Arrest në burg" të djalit të saj S. K., nuk ka mbajtur parasysh rrethana që lidhet me probleme të shëndetit të tij mendor.

Ankesa e shtetasës Drita Kora , është shoqëruar dhe me një vërtetim lëshuar nga Spitali 5 në Qendrën Spitalore "Nënë Tereza" Tiranë më datë 17.02.2016, i cili bën fjalë se pacienti S. K., paraqitet me "çrregullime psikotike".

Në shkurtimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr.400 akti, datë 16.02.2016, thuhet se ajo gjykatë ka vleftësuar të ligjshëm arrestimin e shtetasit Samet Kora dhe ka vendosur masë sigurimi arrest në burg, për veprën penale të "Vjedhjes" e mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 134/1 e 22 të Kodit Penal.

Institucioni i Avokatit të Popullit, rastin e ankesës së shtetasës D. K., e ka ndjekur me shqetësim për faktin se familja e saj Rome i përket një shtrese në nevojë, çka do të thotë që gjëndja ekonomike financiare e dobët në të cilat ajo

ndodhet nuk i ka krijuar mundësinë e caktimit një avokati mbrojtës për djalin e saj, i cili do të paraqiste dhe shtronte para Prokurorisë dhe Gjykatës, rrethana të tilla që duhet të mbaheshin në konsideratë për të mos vendosur ndaj tij masën ekstreme, atë të “arrestit në burg”. Pra, nëpërmjet sugjerimit tonë insistojmë që personi nën hetim S. K., të ketë të gjitha të drejtat të cilat i sigurojnë një procedim të rregullt ligjor dhe nga ana tjetër predispozicionin e organit procedues për t’i respektuar ato.

Është detyra e organit procedues që në kushtet e paraqitura, duke patur indicie se personi nën hetim Samet Kora, paraqitet me problem të shëndetit mendor, të respektojë kërkesat e parashikuara në nenin 43 të Kodit të Procedurës Penale, për të përcaktuar përgjegjshmërinë e tij dhe të urdhërojë kryerjen e ekspertimit psikiatriko-ligjor.

Mandej, pasi të administrojë aktin e ekspertimit psikiatriko-ligjor, në funksion me të, në rast se del se gjëndja mendore e të pandehurit duhet të kurohet, t’i drejtohet gjykatës me kërkesë, me qëllim që ajo të vendosë shtrimin e tij në një institucion psikiatrik.

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, personat me çrregullime të shëndetit mendor i shikon si persona të paaftë e të cënueshëm. Për rrjedhojë atyre duhet t’u sigurohet trajtim i duhur mjekësor, përshtatshmëri e ndihmës dhe përkujdesje mjekësore në një institucion psikiatrik i specializuar, i cili duhet të jetë jashtë sistemit të burgjeve.

Veç sa sipër pavarësisht përfundimit që do të arrihet nga ekspertimi psikiatriko-ligjor lidhur me përgjegjshmërinë e personit nën hetim, organi procedues në fazën e hetimeve paraprake duhet të realizojë hetime të gjithanshme dhe të sqarojë e vërtetojë qëllimin dhe motivin e kryerjes së veprimit të kundërligjshëm nga shtetasi S. K. Më pas procedimi penal duhet të analizohet në tërësinë e tij, dhe për marrjen e vendimit përfundimtar sugjerojmë të mbahen në konsideratë dhe rrethana të tilla si mosha, niveli arsimor i ulët, kushtet dhe gjëndja jo e mirë ekonomike e shtetasit S. K.

*Në bazë të nenit 63/3 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrate publike”, si dhe nenit 21 gërma “c” të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” me ndryshimet përkatëse, “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vënd të së drejtës së shkelur, tek organi epror i organit që ka shkaktuar shkeljen”,*

## **REKOMANDOHET**

“Kryerja e ekspertimit psikiatriko-ligjor për personin nën hetim S. K., antar i Komunitetit Rom, për akuzën “Vjedhja” e mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 134/1 e 22 të Kodit Penal”.

Mbi mënyrën e shqyrtimit të Rekomandimit tonë, lutemi të vihemi në dijeni jo më vonë se 30 ditë nga dërgimi tij, kërkesë kjo e parashikuar në nenin 22 të ligjit "Për Avokatin e Popullit".

Bashkëlidhur ju dërgojmë dokumentet e mëposhtme:

1. Ankesa e shtetases D. K., datë 17.02.2016.
2. Vërtetim i datës 17.02.2016, i Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë.

*Duke besuar në mirëkuptimin Tuaj.*

**K O M I S I O N E R I**

Konc. & Dakt. P.A.  
Tiranë më 03.03.2016

**Arben SHKËMBI**